

**AKTI I THEMELIMIT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“THOSE” shpk**

Sot, Më datë 18/05/2021, shoqëria krijohet nga ortakët themelues:

- 1) Artion Plaku, atësia Luan, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J20521001B, i datëlindjes 21/05/1992, lindur në Ura Vajgurore dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 2) Fatjon Bruçi, atësia Faik, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I71128042U, i datëlindjes 28/11/1987, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 3) Lavdosh Bala, atësia Haki, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal F40922043O i datëlindjes 22/09/1954, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:
Themelimi**


- 1) Emri i shoqërisë është “THOSE” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Shërbim Bar, Kafe, Lounge, Restorant, shërbim Kateringu si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike qe do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar. Shoqëria do të kryejë gjithashtu dhe import eksport dhe të artikujve të tjerë që shërbejnë për aktivitetin kryesor, paketim dhe ambalazhim të kafesë dhe të ekspresave dhe pajisjeve të tjera të kafese, elektrike, artikuj të ndryshëm ushqimore dhe insdustrial që nuk kufizohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.



Neni 3:
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Refat Putro, ndërtesa 13, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5:
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë dhe është i ndarë në 3 (tre) kuota dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Z. Artion Plaku: Zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 34 lekë që përben 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Fatjon Bruçi: Zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 33 lekë që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Lavdosha Bala: Zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 33 lekë që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:
Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Z. Artion Plaku atësia Luan, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J20521001B i datëlindjes 21/05/1992, lindur në Ura Vajguore dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7:
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.




Neni 8:
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKËT E SHOQËRISË
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“THOSE” shpk


Artion Plaku

(Emër, Mbiemër, Firma)

ARTION PLAKU



Fatjon Bruçi

(Emër, Mbiemër, Firma)

Fatjon Bruçi


Lavdosh Bala

(Emër, Mbiemër, Firma)

SIBORA SPINZAS

Përfaqësuar me prokurorë